

VENDIM
Nr. 124, datë 4.6.2018

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “GAVRAN ENERGY” SHPK ME NR. 349 LICENCE, SERIA PV16K,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT NR. 140, DATË 15.8.2016, PËR PRODHIMIN
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “GAVRAN 1”, ME FUQI TË INSTALUAR
998 kw DHE “GAVRAN”, ME FUQI TË INSTALUAR 1215 kw, ME FUQI TOTALE TË
INSTALUAR 2213 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 8, pikat 1 dhe 2, 10, pika 1 dhe 3 dhe nenit 15, pika 2, germa “a”; pika 4, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe neneve 15 dhe 19 pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi mosfillimin e procedurës për modifikimin e licencës në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 15.8.2016, është e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1” me fuqi të instaluar 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi të instaluar 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw, për një afat 30-vjeçar dhe disponon licencën me nr. 349, seria PV16K.

- Shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., me shkresën e datës 13.5.2016, protokolluar në ERE me nr. 370, datë 8.5.2018, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës me nr. 349, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 140, datë 15.8.2016.

- Aplikimi i shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin A (neni 8, pika 2) nuk është plotësuar.

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) nuk është plotësuar.

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (neni 15, pika 4, germa “b”), nuk është plotësuar.

- Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (neni 15, pika 4, germa “c”) nuk është plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., me nr. 349, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 15.8.2016, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1”, me fuqi të instaluar 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi të instaluar 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw.

2. Nëse shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k. paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti